

Data 22.06.2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E

KRITEREVE PËR KUALIFIKIM DHE TERMAVE TE REFERENCES

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

- **Supervizion punimesh per objektin Furnizimi me uje te pijshem per fshatrat Brezhdan dhe Ushtelence, Njesia Administrative Qender Tomin, Faza e dyte.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- 71247000-1 - Mbikqyrje e Punës se ndërtimit

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 1,110,199.40 (një milion e njëqind e dhjetëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë dyzet) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, njesia e prokurimit prane autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim dhe termave te references për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit “Per Prokurimin Publik si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet te plotesoje kerkesat ligjore **sipas Shtojces 9 te DST.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 82 të LPP.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë viteve financiare 2021, 2022 lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe / ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2022 dhe tremujorin e parë të vitit 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ne të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Ky kriter të përmbushet nepermjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojces Nr.9 të DST.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare**;... 3) Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë **një xhiro vjetore minimale të caktuar**.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

Ne paragrafin 2 germa “c” te ketij neni ku përcaktohet “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”

Si dhe neni 55 paragrafi 4 i kesaj VKM ku parashikohet: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. **Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave**”

Gjithashtu njësia e prokurimit gjykon se bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (te ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë si dhe duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuajduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vetevendore.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe **përvojën e nevojshme** për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 55 paragrafi 4 /b te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: *Për kontratat e mallrave dhe **shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.***

Njësia përcaktoi kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

2.3.2. Bazuar ne *Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.759 datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM Nr.943 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.759 datë 12.11.2014 Operatori Ekonomik duhet të disponoje Liçense profesionale te vlefshme, per mbikqyrje, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise me kategoritë si më poshte:*

- **Kategoria NP- 1** Punime germimi ne toke
- **Kategoria NP- 5** Punime nentokesore, ura e vepra arti
- **Kategoria NP- 7** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- **Kategoria NS- 1** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **Kategoria NS- 8** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura
- **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike

Në rast te bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë licensat në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim ne kontratën e bashkëpunimit.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Gjithashtu kjo kerkese eshte referuar dhe ne zerat e punimeve te kontrates baze. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt i kontrates baze te perfunduar në mbështetje të ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), dhe të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”; operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e

kërkuara të përcaktuara sipas llojit të objektit të punimeve, kërkesa të cilat janë proporcionale me objektin e kontratës.

2.3.3 Staf i inxhinierik i kualifikuar për këto shërbime:

a) Operatori Ekonomik për të realizuar objektin e prokurimit shërbim mbikqyrje, **duhet të ketë pjesë të stafit të tij:**

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet / Topograf

Te cilët të figurojnë në listepagesën e shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Nga stafi i mesiperm, Operatori Ekonomik të ketë **Drejtues Teknik Inxhinier ndërtimi ose Inxhinier hidroteknik**, të cilët të deklarojnë se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.9 Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për stafin inxhinierik të mesiperm duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Kontratë punë e vlefshme gjatë gjithë kohës së realizimit të kontratës;
- Diplomë profesionale;
- License
- CV

Shënim: Staf i angazhuar duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

b) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën **6 (gjashtë) punonjës** për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

- **Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.9. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:**

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

Në nenin 41 “Kërkesat të veçanta për kontratat e shërbimeve” paragrafi 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) ***një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose***
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*

Me qëllim realizimin e objektit të kontratës me objektin e sipercituar, njësia e prokurimit referuar natyrës së shërbimeve që do të kryhen objekt kontrate, si dhe ne referim te termave te references per shërbimin mbikqyrje, te pergatitura nga ky autoritet, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e inxhinierëve me kualifikimet e kërkuara, si dhe me licensat, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar.

Në këto kushte njësia e prokurimit vlerëson që të kërkojë numrin e inxhinierëve të mësipërm dhe kualifikimet përkatëse që kanë lidhje me objektin që po prokurohet duke patur parasysh natyrën e punimeve ne objekt dhe zerat e preventivit te kontrates baze.

2.3.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të paraqese çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte:

Certifikate ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

Certifikate ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

Certifikate ISO 45001: 2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Të gjitha çertifikatat e mësipërme te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se sherbimeve qe do te marre persiper te realizoje, referuar kontrates se bashkepunimit / marreshjes se bashkepunimit te nenshkruar.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte vendosur ne referim te Nenit 41/2 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë **dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi te gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Termt e References

Bazuar në termt e references te pergatitura nga autoriteti kontraktor per kete qellim si dhe duke qene se keto terma plotësojnë kushtet e përcaktuara në Ligjin Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 41 pika 1 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të Prokurimit Publik”, njësia e prokurimit po publikon termat e references për shërbimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **Data: 03.07.2023 Ora: 13.00** vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim nga njësia e prokurimit, u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.